



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:073801

Datë: 05.12.2019

Numri i dokumentit: 00696055

P.nr.102/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të akuzuarit J.T nga fshati ..., Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Avni Ibrahim nga Ferizaj, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj me numër PP/II.nr.843-9/2018, të datës 22.08.2018, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datat 23.07.2019, 01.10.2019 dhe 11.11.2019, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 05.12.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari J.T, nga babai B... dhe nëna H., e lindur H., i lindur me datë ... , në fshatin ..., Komuna e Ferizajt, ku edhe jeton ndërsa jeton dhe punon përkohësisht në shtetin e Zvicrës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 20.04.2018, rreth orës 18:30, në fshatin Greme, Komuna Ferizaj, saktësisht në shtëpinë e të dëmtuarit H.T, i akuzuari shkon tek xhaxhai i tij i dëmtuari për të biseduar rreth një mosmarrëveshje që kishin rreth një kontesti pronësor dhe gjatë bisedës tensionohet situata dhe i akuzuari ngritët në këmbë pastaj edhe i dëmtuari dhe në atë moment e shtynë me duar dhe e rrëzon në shtrat-krevat, pastaj e kap për fytyrë deri ndërhyr dhe ndan gruaja e të dëmtuarit N.T, i dëmtuari mbetet shtrirë deri sa vjen vajza e tij H... dhe e dërgojnë në Qendrën Emergjente në Ferizaj pastaj e dërgojnë në QKUK në Prishtinë.

-Me çka ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës.

andaj gjykata në bazë të nenit 3,4,39,40,42,43,44,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës si dhe nenit 365 të KPP-ës, të akuzuarit i shqipton:

## DËNIM ME BURGIM I CILI DËNIM ME PËLQIMIN E TË AKUZUARIT ZËVENDËSOHET NË DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të akuzuarit J.T, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 150 (njëqindpesëdhjetë) ditësh, i cili dënim në bazë të nenit 44 të KPRK-ës dhe me pëlqimin e të akuzuarit zëvendësohet në dënim me gjobë në shumës prej 2000 € (dymijë euro), të cilën do ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Në bazë të nenit 79 të KPRK-së, të akuzuarit J.T koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 21.04.2018 deri me datë 04.05.2018, do ti llogaritet në dënimin e zëvendësuar me gjobë.

I dëmtuari H.T për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullte juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € pesëdhjetë euro) si dhe në bazë të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### A R S Y E T I M

#### 1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm me datë 22.08.2018, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.843-9/18, kundër të akuzuarit J.T nga Ferizaj, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Gjykata me datë 16.05.2019, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin ish-in prezent prokurori i shtetit dhe i akuzuari J.T, në të cilin shqyrtim pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari kishte deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe lidhur me fajësinë i njëjti kishte deklaruar se nuk e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast gjykata të njëjtin e ka udhëzuar që në kuptim të nenit 245 paragrafi 5 dhe 6 nën paragrafi 6.1, 6.2 dhe 6.3 të KPP-ës mund të paraqet kundërshtimet lidhur me provat e cekura në aktakuzë si dhe kërkesën për hudhjen e aktakuzës por edhe përkundër këtyre udhëzimeve i njëjti nuk e kishte bërë një gjë të tillë andaj gjykata me krijimin e kushteve ligjore me urdhër ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor për datë 23.07.2019, të cilat kanë vazhduar edhe me datat 01.09.2019 dhe 11.11.2019, në të cilat seanca është bërë edhe procedimi i provave lidhur me këtë çështje penale juridike.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e shtjelluara dhe të administruara në seancat e shqyrtimit gjyqësor dhe duke u mbështetur në të gjitha provat materiale dhe ato personale e sidomos duke u bazuar në deklaratën e të dëmtuarit H.T, në deklaratën e dëshmitares N.T, pastaj dëshmitarëve H.T..1 dhe G.J, e pjesërisht edhe në deklaratën e të akuzuarit J.T rezulton se është vërtetuar bindshëm se i akuzuari ka kryer veprën penale sulm nga neni 187 paragrafi 3 i KPRK-së, ngase është e vërtet se ngjarja ka ndodhur në fshatin Greme, Komuna e Ferizajit, në shtëpinë e të dëmtuarit H.T ku i akuzuari pasi që kthehet nga Zvicra, shkon te shtëpia e xhaxhait të tij H.. për ti sqaruar disa probleme pronësore ku aty ish-in prezent i dëmtuari dhe bashkëshortja e tij N... dhe pasi që tensionohet situata që të dy ngritën në këmbë dhe i akuzuari për një moment e shtynë të dëmtuarin e rrezon në shtrat dhe e kap për fyti mirëpo aty ndërhyr dëshmitarja N.. dhe i ndan të njëjtit ku i dëmtuari mbetet i shtrirë në shtrat deri sa bashkëshortja e tij e thërret me telefon vajzën e saj H.B e cila pastaj së

bashku me bashkëshortin e saj e dërgojnë të dëmtuarin në Qendrën Emergjente në Ferizaj e më pastaj i njëjti transferohet në QKUK në Prishtinë, ku dhe posedon raportin mjekësor ndërsa mospranimi i veprës nga ana e të akuzuarit bëhet vetëm për ti ikur përgjegjësisë penale sepse faktet dhe dëshmitë vërtetojnë të kundërtën andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe me rastin e shqiptimit të dënimit ti merr parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndues në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallen e përgjegjësisë penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.T në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim ka deklaruar se nga provat e administruara në gjykatë nuk është vërtetuar se në ngjarjen kritike i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë ngase i dëmtuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar ngjarja ka ndodhur rreth orës 13:00 h e jo siç është prezantuar në akuzën e prokurorit të shtetit rreth orës 18:30 minuta dhe se momentin kur i akuzuari e ka shtyrë të dëmtuarin bashkëshortja e tij nuk ka qenë prezent por ka qenë tek dera dhe se në këtë çështje penalo juridike rezulton se nuk ekziston lidhja kauzale direkt midis dëmtimeve trupore dhe pasojave shëndetësore andaj edhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin J.T në mungesë të provave ta liroj nga akuza për veprën penale e cila i vihet në barrë.

I akuzuari J.T në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe se nuk ka çfarë të shtojë tjetër.

## 2.Provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor

Pas prezantimit të provave, gjykata plotësisht dhe përtej dyshimit të bazuar, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit, këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi në bazë të:

- Dëgjimit të të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit H.T,
- Dëgjimit të dëshmitares N.T
- Dëgjimit të dëshmitares H.B,
- Dëgjimit të dëshmitarit H.T..1
- Dëgjimit të dëshmitares G.J
- Leximit dhe shikimit të provave materiale si: raporti i oficerit, raporti mjekësor nga Qendra Emergjente në Ferizaj, fletë lëshimi nga QKUK në Prishtinë me numër 633, ekspertiza mjekoligjore e datës 18.06.2018, raporti i policit hetues i datës 23.04.2018, raporti i policit hetues i datës 02.05.2018 si dhe
- Mbrojtjen e të akuzuarit J.T.

### 2.1. Deklarata e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit H.T

I dëmtuari H.T në dekalartën e tij të dhënë në seancës n e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën e kishte ftuar të akuzuarin në shtëpinë e tij i cili më pas kishte shkuar dhe ishin duke ndenjtur në sallonin shtëpisë dhe të njëjtit kishin filluar një debat rreth disa çështjeve pronësore dhe më pas duke biseduar dhe pas tensionimit të bisedës ndërmjet tyre ishin ngritur në këmbë dhe më pas i akuzuari e kishte kapur për fyti dhe e kishte shtyrë dhe si pasojë e shtyrjes i njëjti kishte rënë nga një krevat në krevatin tjetër dhe më pas kishte rënë me kokë në tokë dhe e kishte humbur vetëdijen, aty kishte qenë prezent edhe bashkëshortja e këtui dëshmitarja N.T dhe se e gjithë ngjarja ka ndodhur rreth 10 minuta por nuk mund ta di saktë.

## 2.2 Deklarata e dëshmitares N.T

Dëshmitarja N.T në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar në ditën kritike J.T ka qenë në shtëpinë e tyre pasi që të njëjtën e kishte tharur i dëmtuari dhe pasi që i njëjti erdhi u ulën në krevat njëri në njërin krevat dhe tjetri në tjetrin krevat dhe i akuzuari J.T i tha se dua ta shtrojë me asfalt rrugën ka megja e arës ndërsa i dëmtuari i kishte thënë jo ,ndërsa i akuzuari i kishte dhënë po dhe në një moment janë ngritur në këmbë që të dy dhe i akuzuari e kishte kapur për fyti të dëmtuarin ndërsa dëshmitarja i kishte thënë se “ a po don me mbyt breh zoti të marroftë ” ndërsa i akuzuari i kishte thënë “du me myt rodin e nones ia qifsha” dhe e shtyu në krevat pastaj i dëmtuari me kokë e ka goditur tavolinën e cila gjendet në sallon dhe i njëjti kishte mbetur i shtrirë, ndërsa i akuzuari doli nga aty dhe as që u kthye për ta shikuar të dëmtuarin, pastaj dëshmitarja kishte dalë në rrugë dhe e kishte takuar një vajzë të cilës ia kishte dhënë telefonin për ta thirrur vajzën e saj H...për ta njoftuar me rastin, dhe më pas e njëjta kishte shkuar aty.

## 2.3. Deklarata e dëshmitares H.B

Dëshmitari H.B në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike posa kam marrë vesh lajmin rreth rastit, rreth orës 18:00 h së bashku me bashkëshortin e saj kishte shkuar në fshatin ... tek shtëpia e prindërve të saj përkatësisht të dëmtuarit dhe kur kishte hyrë brenda në shtëpi në sallon e kishte parë të dëmtuarin të shtrirë duke i rrjedhur shkurmbë për gojë ndërsa dorën e majtë e kishte të nxirë dhe më pas të njëjtin me veturën e bashkëshortit e kishin dërguar në emergjencën e spitalit të Ferizajit dhe se e njëjta nuk e kishte ditur arsyen e rastit të ndodhur dhe tek më vonë nëna e saj i tregon se deri sa i akuzuari dhe i dëmtuari kanë qenë duke biseduar për një moment janë ngritur në këmbë dhe më pas i akuzuari e kishte kapur për fyti të dëmtuarin dhe e kishte shtyu ne krevat.

## 2.4. Deklarata e dëshmitarit H.T..1

Dëshmitarja H.T..1 në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike ka thënë se kur kishte ndodhur rasti ai kishte qenë në Gjermani dhe se për këtë gjë ishte njoftuar nga motra dhe mbesa të cilat i kishin thënë se J.. e ka rrahur H... në shtëpinë e tij , me ç'rast i njëjti iu kishte thënë se rastin duhet ta lajmojnë në polici, gjithashtu i njëjti ka deklaruar se nuk e ka ditur asnjëherë që të njëjtin kanë pasur probleme, dhe se që të vijë puna që i akuzuari t'ia rrah babin e tij nuk e kishte menduar, i njëjti kishte ardhur nga Gjermania 6 ditë pas rastit dhe kishte shkuar drejt në stile ku gjendej i dëmtuari, e më pas nëna e tij e kishte njoftuar se i akuzuari dhe i dëmtuari deri sa ishin duke biseduar janë nervozuar në mes veti janë ngritë në këmbë dhe i akuzuari e ka kap për fyti të dëmtuarin dhe e kishte shtyrë në krevat dhe më pas nga krevati i kishte rënë me kokë tavolinës dhe i kishte thënë “ ta qifsha rodin e nënës ”.

## 2.5. Deklarata e dëshmitarës G.J

Dëshmitarja G.J në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike ka qenë me prindërit dhe me kolektiv në darkë dhe se deri sa ishin aty babi i saj kishte marrë një thirrje telefonik dhe ishte stresuar me ç'rast kishte dal jashtë lokalit dhe më pas kishte dal edhe dëshmitarja e cila e kishte dëgjuar babin e saj duke thënë “ qysh e ka rreh J...”, dhe kur e përfundoi bisedën me telefon i kishte thënë se daja J... ta paska rreh gjyshin tëndë dhe më pas prej aty kishin vazhduar për në emergjencën e në Ferizaj, duke biseduar me tezen e saj H... të cilën e kishte pyetur se çfarë ka ndodh e njëjta i ishte përgjigjur se nëna (gjyshja) me ka thënë se J.. e ka rreh gjyshin tënd.

## 2.6. Mbrojtja e të akuzuarit J.T

I akuzuari J.T në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kur ka ardhur nga Zvicra ka qenë rreth orës 11:00 h, dhe se kishte ardhur për ta marrë motrën e tij B.R të cilës ia kishte bërë një vizë, së pari kishte shkuar tek vëllai i tij pastaj tek shtëpia e tij dhe agja i tij- i dëmtuari kishte qenë në terasën e shtëpisë së tij, i cili i kishte thënë “ a po vjen deri te unë”, ndërsa i njëjti i kishte thënë se po shkoj në shtëpi njëherë për ti hap dritaret për tu ajrosur shtëpia mirëpo i dëmtuari i ka thënë “hajde se ka me të pyet diçka”, pastaj ka i akuzuari ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit ka hyrë brenda dhe se kanë filluar për të bërë muhabet si çdo herë, më pas i dëmtuari ka filluar ta pyet për se ka ardhur në Kosove dhe se i është përgjigjur kam ardhur me marrë motrën dhe pasi që vëllezërit e kanë shtruar rrugën edhe që të punoj nga pak, me ç’rast i dëmtuari i ka thënë se N...- vëllau i J... nuk është duke bërë mirë që është duke e shtruar rrugën sepse është duke punuar shumë afër mexhes së tij e më pas i akuzuari i kishte thënë sa a ka dal ingjinjeri me i matë, i dëmtuari i ka thënë që me “nasip” duhet të ik 1 metër prej mexhes, i njëjti i ka thënë masi ti me ik një metër edhe ne një metër ta bëjmë rrugë të përbashkët, kurse i dëmtuari i ka thënë se mua nuk më duhet rruga, pastaj ka ndërhyrë bashkëshortja e të dëmtuarit e cila iu ka thënë “boll bre plak që 50 vjet nuk u ngjite me mexhe leje djalin rahat ka ardhë nga Zvicra” dhe në këtë moment i dëmtuari është bërë nervoz me bashkëshorten e tij dhe e ka gjuajtur fletoren të cilën e kishte në dore dhe ka thënë se askush nuk po më dëgjon as djemtë e as ju dhe se i akuzuari ka dashur që të dalë nga shtëpia mirëpo i dëmtuari i ka thënë se kam edhe diçka që bisedoj me ty se jam duke e shitur oborrin e vjetër dhe po dua ta shes ty dhe se i njëjti i ishte përgjigjur nuk dua ta blej se nuk më nevojitet, aty ka qëndruar rreth 1 orë e 30 minuta me ç’rast të dëmtuarin dhe gruan e tij i ka shërbyer me nga një lëngë dhe pastaj ka shkuar tek vëllai i tij për të ngrënë drek, pastaj në mbrëmje në Ferizaj, ndërsa nga ora 20:00 h në mbrëmje kishte shkuar në Kaçanik në hotelin “E...”, ku është takuar me mjeshtrit dhe ka ndejtur deri në ora 00:30 minuta, në shtëpi ka mbërritur në ora 01:30 minuta me ç’rast kishin ardhur policia dhe se i njëjti nuk e ka ditur se për çka kanë ardhur ata dhe për arsyen e intervistimit të tij e kishte kur ka shkuar në Stacionin Policor në Ferizaj, të cilët i kishin treguar se mixha i tij këtu i dëmtuari gjindet në spital dhe se me të dëmtuarin më herët nuk kanë pasur asnjë problem, të njejtin nuk e kishte kapur për fyte dhe shtyer por vetëm se kanë bërë muhabet me të.

## 3.Vendimi lidhur me ricilësimin juridik të veprës penale dhe zbatimin e ligjit më të favorshëm.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare së pari bërë ricilësimin juridik të veprës penale nga sulmi nga neni 187 paragrafi 3 i KPRK-ës ashtu siç është ngritur akti akuzues në veprën penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-ës ngase në rastin konkret gjykata gjeti se i dëmtuari H.T nuk bënë pjesë në grupin e personave të cilët konsiderohen si viktimat të ndjeshme konform nenet 120 pika 37 e KPRK-ës sepse në këtë kategori bëjnë pjesë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, personat me aftësi të zvogëluar, gruaja shtatzënë ose partneri familjar ndërsa në rastin konkret i akuzuari dhe i dëmtuari ishin në marrëdhënie familjare përkatësisht të njejtin ishin axhë dhe nip të cilët nuk jetonin në të njejtën bashkësi familjare dhe si rrjedhojë i dëmtuari nuk bënë pjesë në kategorinë e lartcekur, ndërsa pas ricilësimit të veprës penale gjykata duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 2 të KPRK-ës sipas të cilit thuhet “*Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm*”, konsideroi se në këtë çështje penalo juridike ndaj të akuzuarit të lartcekur duhet të zbatohet Kodi Penal i Republikës së Kosovës me numër 06/L-074 i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.04.2019, e jo Kodi Penal i Republikës së Kosovës me numër 06/L-082, i cili ka qenë në fuqi në kohë e kryerjes së veprës penale sepse sipas nenet 187 paragrafi 1 të KPRK-ës me numër 06/L-082, e cila ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale është paraparë dënim gjorbë ose me burgim deri në 3 vite

ndërsa sipas nenit 184 paragrafi 1 të KPRK-ës me numër 06/L-074, e cila është në fuqi tani për veprën penale të sulmit është paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në 1 vit.

#### 4.Elementet e veprës penale

Në nenin 184 paragrafi 1 i KPRK-ës është parashikuar “Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, pa pëlqimin e atij personi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit, çka nënkupton se kjo veprë konsiderohet se është kryer në çdo rast kur ndokush me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër dhe se kjo veprë penale do të konsiderohet se ekziston me kusht që viktimës të mos i shkaktohen lëndime trupore, po ashtu duhet theksuar faktin se këtë veprë penale mund ta kryej çdo person dhe mund të kryhet vetëm me dashje dhe atë me dashje direkte.

#### 5. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, gjykata konform nenit 7 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundur të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me çrast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se deklaratës së të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit H.T, deklaratave të dëshmitarëve N.T, H.B, H.T..1 dhe G.J duhet ti falet besimi ngase të njejtat janë në harmoni edhe me provat e tjera materiale të cilat janë administruar nga ana e gjykatës ngase dëshmitarët faktet i kanë treguar në mënyrë të njëjtë, gjë kjo e cila edhe ua ka ngriti vlerën e besueshmërisë së këtyre deklaratave sepse të gjithë në mënyrë të njëjtë kanë deklaruar se me datë 20.04.2018, rreth orës 18:30 minuta në fshatin Greme, Komuna e Ferizajit, në shtëpinë e të dëmtuarit H.T, i akuzuari J.T kishte shkuar tek axha i tij i cili e kishte ftuar për të biseduar rreth një mosmarrëveshje pronësore dhe gjatë bisedës është tensionuar situata me çrast i akuzuari ishte ngritur në këmbë e më pas edhe i dëmtuari dhe në atë moment i akuzuari e kap për fyti dhe e shtyen të dëmtuarin në shtrat dhe më pas ndërhyr bashkëshortja e të dëmtuarit këtu dëshmitarja N.T dhe i ndan të njejtit derisa i dëmtuari mbetet i shtrirë deri sa vie vajza e tij H... dhe më pas të njejtin e dërgojnë në Qendrën Emergjente në Ferizaj dhe nga aty në QKUK në Prishtinë për tretman mjekësor meqenëse i njejtin kishte humbur vetëdijen, këtë gjendje faktike po ashtu e vërtetojnë edhe deklaratat e të dëmtuarit H.T dhe dëshmitares N.T të cilët kanë qenë prezent në shtëpi në momentin kur kishte ardhur i akuzuari dhe i cili pas bisedave të zhvilluara me të dëmtuarin për problemet pronësore pasi tensionohet ngritet në këmbë dhe deri sa dëshmitarja N... ishte duke ia hapur derën e dhomës për të përcjellur për në shtëpi të akuzuarin, ai e kap për fyti të dëmtuarin dhe e shtyen në krevat e më pas i dëmtuari me kokë bie në cepin e tavolinës së dhomës dhe mbetet i shtrirë deri në momentin kur aty kishte ardhur vajza e tij H... e cila me bashkëshortin e saj e kishin transportuar të njejtin për në emergjencën e Spitalit Regjional të Ferizajit, kjo gjendje faktike si dhe deklaratat e të dëmtuarit dhe dëshmitares N.T të cilët ishin prezent kur kishte ndodhur rasti gjejnë mbështetje edhe në deklaratat e dëshmitarëve H.B, H.T..1 dhe G.J të cilët nuk kanë qenë dëshmitarë okular të rastit mirëpo të njejtin në mënyrë të njëjtë dhe identike me deklaratat e të dëmtuarit dhe dëshmitares N... e kanë treguar rrjedhën e rastit si dhe veprimet e të akuzuarit J.T mbi bazën e të cilave gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formësohen elementet e veprës penale të sulmit nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-ës, për të cilën i njejtin është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë çështje penalo juridike gjykata gjeti se në këtë çështje penalo juridike nuk ishte kontestuese fakti se me datë 20.04.2018, i akuzuari kishte shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit pasi që i njëjti e kishte ftuar atë për të biseduar lidhur me disa probleme pronësore ngase këtë fakt nuk e mohon as vet i akuzuari i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar se me datë 20.04.2018 kishte qenë në shtëpinë e të dëmtuarit, po ashtu nuk ishte kontestues as fakti se i akuzuari dhe i dëmtuari gjatë zhvillimit të bisedës ishin tensionur në mes vete lidhur problemet pronësore ngase këtë fakt e pohojnë i dëmtuari, dëshmitarët si dhe vet i akuzuari.

Konstatuese në këtë çështje penalo juridike ishte koha e kryerjes së veprës penale meqenëse i akuzuari në mbrojtjen e tij kishte thënë se në kohën kur i njëjti akuzohet se e ka kryer veprën penale përkatësisht rreth orës 18:30 minuta i njëjti kishte qenë në Ferizaj e më pastaj në Kaçanik tek hotel “E...” dhe se është e vërtet se ai ka qenë tek axha i tij por rreth orës 13:00 h ashtu siç kishte thënë edhe i dëmtuari në deklaratën e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor mirëpo gjykata këtë fakt e zgjodhi duke u bazuar në deklaratën e të dëmtuarit H.T të dhënë në prokurori, deklaratat e dëshmitares N.T të dhëna në prokurori dhe polici dhe në shqyrtim gjyqësor si dhe dëgjimit të dëshmitarëve H.T dhe G.J të cilët në mënyrë identike deklarojnë se i gjithë rasti kishte ndodhur rreth orës 18:30 minuta në shtëpinë e të dëmtuarit H.T, mbi të gjitha ky konstatim gjen mbështetje edhe në vet deklaratën e të akuzuarit J.T të dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me datë 21.04.2019 ku ndër të tjera i njëjti kishte deklaruar se *“rreth orës 18:00 axha im më kishte ftuar për të biseduar në lidhje me këtë problem dhe ku unë kam shkuar në shtëpinë e tij dhe aty ka qenë prezent edhe gruaja e tij”*, po ashtu ky konstatim gjen mbështetje edhe në provat e tjera materiale duke filluar nga kallëzimi penal me numër të rasti 2018-CF-652, deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në polici si dhe provat e tjera çka rrjedhimisht për gjykatën pamëdyshje është vërtetuar se i akuzuari J.T në shtëpinë e të dëmtuarit kishte qenë rreth orës 18:00-18:30 minuta kur edhe ishte kryer vepra penale.

Po ashtu në këtë çështje penalo juridike kontestues ishte fakti nëse i akuzuari i kishte ndërrmarë veprimet ashtu siç përshkruhet në aktin akuzues mirëpo gjykata deri tek një konstatim se i njëjti kishte vepruar në mënyrën siç përshkruhet në aktakuzë erdhi po ashtu erdhi duke ia falur besimin e plotë sidomos deklaratave të të dëmtuarit H.T dhe dëshmitares N.T ngase të njëjtit në mënyrë identike deklarojnë se i akuzuari pas tensionimit të bisedës ngritet në këmbë e kap për fyti të dëmtuarin dhe më pas e shtyen të njëjtin në krevat, deklarata të cilat gjejnë mbështetje edhe në deklaratat e dëshmitarëve të tjerë si H.B, H.T..1 dhe G.J ngase edhe pse të njëjtit në mënyra të ndryshme e kishin marrë lajmin se i akuzuari J.T e kishte sulmuar të dëmtuarin H.T mirëpo sa i përket mënyrë se sulmit përkatësisht përshkrimi të veprimet të të akuzuarit ata të gjithë në mënyrë të njëjtë kishin deklaruar se pasi që i akuzuari kishte shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit për të biseduar rreth një problemi pronësor në mes tyre, gjatë zhvillimit të bisedës ishin tensionuar në mes vete me çrast i akuzuari ishte ngritur në këmbë, e kishte kapur për fyti të dëmtuarin dhe më pas e kishte shtyer në krevat çka për gjykatën pamëdyshje është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i akuzuari J.T me datë 20.04.2018, rreth orës 18:30 minuta në fshatin Greme, Komuna e Ferizajit, përkatësisht në shtëpinë e të dëmtuarit H.T, pas bisedave me të lidhur me problemet pronësore, gjatë bisedës të njëjtit tensionohen me çrast ngriten në këmbë e më pas i akuzuari e kap për fyti të dëmtuarin dhe më pas e shtyen në krevat.

Gjithashtu sa i përket pretendimit të mbrojtjes se i akuzuari kishte qenë tek i dëmtuari rreth orës 13:00 h dhe se nuk e kishte kryer veprën penale e cila i vihet në barrë gjykata një mbrojtje të tillë nuk e pranoi për faktin se e njehta përveç që është në kundërshtim të plotë me deklaratat e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve të cilave gjykata ia fali besimin e plotë, mbrojtja e tillë është në kundërshtim të plotë edhe me provat materiale të cilat i shtjelloi dhe analizo gjykata sepse gjykata me kujdes të veçant mbi të gjitha ka analizuar deklaratën e të dëmtuarit dhe konsideroi se i njehti për shkak të moshës së tij meqenëse i njehti është i moshës 80 vjeçare, faktit se i njehti kishte humbur vetëdijen nga rasti i ndodhur dhe kishte qëndruar për shumë ditë pa vetëdije ai edhe ka mund të bëjë një lëshim lidhur me kohën e kryerjes së veprës penale e gjitha kjo duke pasur parasysh edhe faktin se nga koha e kryerjes së veprës penale deri në dëgjimin e tij në seancën e shqyrtimit gjyqësor kishin kaluar mbi 1 vit çka nënkupton se bazuar në moshën e tij dhe gjendjen e tij shëndetësore pas kryerjes së veprës penale është e natyrshme që i njehti të ketë bërë një lëshim lidhur me kohën e kryerjes së veprës penale sepse ngase siç është cekur më lart pamëdyshje nga provat e administruara në seancat e shqyrtimit gjyqësor pamëdyshje është vërtetuar se koha e kryerjes së veprës penale ka qenë rreth orës 18:30 minuta a jo siç aludon i akuzuari duke u bazuar në deklarinimin e të dëmtuarit i cili kishte thënë se rasti ka ndodhur rreth orës 13:00 h.

Po ashtu sa i përket pretendimit të mbrojtjes së në këtë çështje penalo juridike nuk ekziston lidhja kauzale në mes të veprimit të të akuzuarit dhe pasojës së shkaktuar dhe se ky pretendim gjen mbështetje edhe në provat materiale si ekspertiza mjekoligjore e datës 18.06.2018, raportet mjekësore në emër të të dëmtuarit, fletëlëshimi nga QKUK në Prishtinë me numër 633 në emër të të dëmtuarit gjykata një pretendim të tillë nuk e mori parasysh edhe nuk u lëshua në vlerësimin e mëtejme ngase vepra penale për të cilën është shpallur fajtor J.T është sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës sipas të cilit del se kjo vepër konsiderohet se është kryer në çdo rast kur ndokush *me dashje përdor forcën* ndaj personit tjetër dhe se kjo vepër penale do të konsiderohet se ekziston *me kusht që viktimës të mos i shkaktohen lëndime trupore*, çka në rastin konkret vërtetohet se nga veprimet e tël akuzuarit, të dëmtuarit nuk i janë shkaktuar lëndime trupore ngase po të vërtetohet një fakt i till atëherë i njehti do të akuzohej për vepër penale me pasojë lëndimet trupore po ashtu sa i përket provave materiale si ekspertiza mjekoligjore e datës 18.06.2018, raportet mjekësore në emër të të dëmtuarit, fletëlëshimi nga QKUK në Prishtinë me numër 633 në emër të të dëmtuarit gjykata konstaton se të njejtat vërtetojnë faktin se i dëmtuari pas kryerjes së veprës penale ka pasur tretman mjekësor për një kohë relativisht të gjatë mirëpo edhe sipas ekspertizës mjekoligjore të datës 18.06.2019 thuhet se nuk ekziston lidhja kauza midis dëmtimeve trupore dhe pasojave shëndetësore andaj edhe me të drejtë vepra penale është kualifikuar në sulm nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës ngase po të kishte lidhje kauzale ndërmjet veprimit të të akuzuarit si dhe pasojës së shkaktuar e për të cilat i dëmtuari ka pranuar tretman mjekësor atëherë do të bëhej fjalë për vepër tjetër më të rëndë penale e jo për atë për të cilën i njehti është shpallur fajtor dhe është dënues si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## 6.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim që është vërtetuar plotësisht gjendja faktike si dhe është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i akuzuari J.T, me dashje ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-ës, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se nuk ka asnjë rrethanë që e përjashton ndjekjen penale ose përgjegjësinë penale të kryesit dhe të njejtit i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



## 7.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 150 (njëqindnjëzetepesëdhjetë) ditësh i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit si dhe në bazë të nenit 44 të KPRK-ës është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 2000 € (dymijë euro) të cilin do ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen e të akuzuarit me gjykatën ku i njehti gjithnjë i është përgjigjur ftesave të gjykatës për pjesëmarrje në seanca gjyqësore në të gjitha fazat e procedurës penale, sjelljen e mëparshme dhe karakteristikat e të akuzuarit, ku sipas shkresave të lëndës shihet se për të akuzuarin është hera e parë që i njehti bie ndesh me ligjin, po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori parasysh sjelljen e kryesit pas kryerjes së veprës penale ku nga shkresat e lëndës por edhe deklaratimet e palëve shihet se të njejtit më nuk kanë pasur probleme në mes vete ndërsa me rastin e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë dhe caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mori parasysh edhe gjendjen ekonomike të të akuzuarit ngase sipas vet deklaratimit të të akuzuarit i njehti është i punësuar në shtetin e Zvicrës dhe gjendja ekonomike e tij është e mirë andaj gjykata konsideron se me këtë dënim të njejtit nuk i cënohet mirëqenia e tij por as e anëtarëve të tjerë të familjes së tij ndërsa si rrethanë rënduese gjykata për të akuzuarin mori parasysh shkallën e lartë të dashjes nga ana e personit të dënuar meqenëse i njehti bazuar në provat e administruara në gjykat del se pas bisedave me të dëmtuarin si dhe pas tensionimit të bisedës mes tyre pasi që është ngritur në këmbë me dashje e ka kapur për fyti të dëmtuarin dhe më pas të njejtin e ka shtyer duke e përplasur në krevat, çka nënkupton se i njehti duke qenë i vetëdijshtëm se me veprimin e tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar përkatësisht është i vetëdijshtëm për rrezikun konkret (lëndimin e të dëmtuarit duke pasur parasysh moshën e tij) megjithatë i njehti ndërrmer veprimin dhe dëshiron shkaktimin e pasojës së rrezikshme po ashtu si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori parasysh edhe moshën e viktimës përkatësisht të dëmtuarit i cili është i moshës 80 vjeçare çka nënkupton se se i njehti duke pasur parasysh moshën e tij dhe gjendjen fizike të tij ai ka qenë posaqërisht i pambrojtur andaj edhe mbi të lartcekurat gjykata konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit po ashtu gjykata konsideron se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

## 8.Vendimi për kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarin H.T e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko-civil.

### 9.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta obligojë që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe në bazë të ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.102/19, me datë 05.12.2019

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermahaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatë Themelore në Gjilan.